



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14324 Prot.

Lezhë, më 30 . 07 . 2021

VENDIM

Nr. 121 Datë 29 . 07 . 2021

Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021 dhe PBA-në 2021-2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të VKM nr. 359, datë 16.06.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, dhe caktimin e bashkisë si njësi zbatuese”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtesë në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 dhe për vitet 2022-2023, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 58,936,598 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 235,746,392.44 lekë.

2/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti rrugor” për vitin 2021 në shumën 58,936,598 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 235,746,392.44 lekë, respektivisht:

a-Për punimet e ndërtimit të objekti për vitin 2021 në shumën 58,142,095.2 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 231,871,676.72 lekë.

b-Për mbikqyrje punimesh për vitin 2021 në shumën 794,502.8 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 3,178,011.41 lekë.

c-Kolaudim dhe përgatitje dokumentacioni për vitet 2022-2023 në shumën 696,704.31 lekë.

Veprimet të kryhen si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604, për vitin 2021 në shumën 58,936,598 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 235,746,392.44 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.231, për vitin 2021 në shumën 58,936,598 lekë dhe për vitet 2022-2023 në shumën 235,746,392.44 lekë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ANEST RAKAJ

